

Prof. Asoc. Dr. Mark Marku*

Dixhitalizimi: Perspektiva pluraliste dhe diversiteti i mediave shqiptare

I. Aksesit, pavarësia dhe pluralizmi i mediave dixhitale.

Procesi i kalimit nga sistemi analog i transmetimit në sistemin e transmetimeve dixhitale bashkë me përparësitë e padiskutueshme sjell edhe një sërë problematikash që kanë shkaktuar një debat të gjërë e të gjallë ku janë përfshirë shumë aktorë të shoqërisë: prodhues të përmbajtjeve, konsumuesit e tyre, institucione politikëbërëse dhe ligjberëse. —Në ambient dixhital – thonë Marsden and Arino, ka shumë përparësi, (cilësi, mundësi zgjedhje, konkurrencë, zhvillim), por ndeshet edhe me shumë pengesa, (trashëgimi e analogut, pasiguri, deformime potenciale të konkurrencës, dështime ekonomike”¹ Si i tillë debati ka ngjallur edhe interesin e studiuesve të mediave dhe komunikimit kontributi i të cilëve në jo pak raste ka ndikuar në orientimin e këtij debati. Një sintezë e këtij debati është parë me rëndësi nga autori i këtij studimi për të inkuadruar problematikën e procesit shqiptar të dixhitalizimit në një kuadër më global dhe bashkëkohor. Tek e fundit nuk ka pse të mos e shndërrojmë vonesën tonë në procesin e dixhitalizimit në një përparësi për faktin se kemi mundësi t’i zhfrytëzojmë përvojat dhe debatin rreth këtyre përvojave për një kalim me sa më pak probleme nga sistemi analog në atë dixhital.

* Departamenti I Gazetarisë dhe Komunikimit, Universiteti i Tiranës,
Email[; markmarku@hotmail.com

¹ Marsden, C. Arino, M. (2005 Digitisation and Convergence of Interactive Platforms, botuar në Digital Terrestrial Television in Europe, nën kujdesin e Brawn, A. dhe Picard, B. R. LEA, London, f. 8.

Thuajse të gjithë autorët dhe grupet e ekspertëve që janë marrë me procesin e dixhitalizimit dhe problematikave që burojnë prej tij, bien dakort se sfidat kryesore të dixhitalizimit janë aksesin, pavarësia dhe pluralizmi. —Nëçdo vend politikat tradicionale që garantojnë vlerat demokratike si pluralizmi dhe aksesin në media përballen me sfida të reja²- thuhet në raportin e Këshillit shkencor për politikën qeveritare të Hollandës. Duke i përkufizuar terma të tillë si aksesin, pavarësia dhe pluralizmi grupi i studiuesve hollandezë saktësojnë se ato janë përkthime specifike të vlerave abstrakte si liria dhe barazia³. —Ndërrëprimi mes lirisë dhe barazisë- saktësojnë më tej ata, mund të përmbledhet kështu: Liria shihet si pikënisje. Barazia konsiderohet si një e drejtë që mishërohet në sundimin e ligjit ku edhe mbështetet çdo politikëbërje. Barazia në kontekstin e mediave nënkupton aksesin. Nëse njerëzit nuk kanë akses të barabartë në informacion kjo sjell pabarazinë shoqërore. Ndërkohë që pavarësia është një prej aspekteve themelore të lirisë⁴. Dixhitalizimi, pra shihet si një mundësi e mirë për diversifikimin e programave nga pikëpamja teknologjike. Por, teknologjia për shkak të koston së lartë i bën zotëruesit e rrjeteve të jenë gjithnjë e më të orientuar drejt një logjike tregu si e vetmja mundësi për ekuilibrimin financiar kosto-fitim. Qeveria dhe autoritetet rregullatore duke respektuar rregullat e tregut dhe interesat financiare të operatorëve do të duhet të mbajnë parasysh faktin se infrastruktura dixhitale është një pasuri publike që u është dhënë për përdorim operatorëve privatë. Për këtë arsye kjo pasuri publike duhet administruar jo në dëm të interesit të qytetarëve apo në kundërshtim me të drejtat dhe liritë themelore të tyre. Studiuesit bien dakort që autoritetet rregullatore duhet të ushtrojnë rolin e tyre dhe duhet të garantojnë, programe të diversifikuara, informacion të paanshëm, pluralizmin politik dhe diversitetin kulturor, ndarjen e kufijve mes informacionit dhe publicitetit, garantimin e standarteve të programeve dhe bashkëpunimin me audiencat për kontrollin e këtyre

² Media Policy for the Digital Age, (2005) WRR/Amsterdam University Press, The Hague/Amsterdam. F. 9.

³ Po aty. f. 20.

⁴ Po aty. F. 20.

standarteve, mbrojtjen e disa kategorive moshore nga dhuna dhe pornografia dhe aksesin në informim për grupet e marginalizuara dhe minoritetet etnike

Qasja thjesht ekonomike nuk është e mjaftueshme për t'u përballur me sfidën e pluralizimit dhe diversifikimit të përmbajtjeve. Logjika e tregut duhet të përputhet në këtë rast me logjikën e funksioneve që media duhet të ketë në një shoqëri të lirë dhe demokratike. Grupi i studiuesve të Amsterdemit por edhe studiues të tjerë mendojnë se nëse mediat dixhitale duan të përmbushin rolin dhe funksionet e tyre në shoqëritë demokratike ku operojnë duhet të garantojnë disa standarte specifike për lloje të caktuara përmbajtjesh. Ata përcaktojnë pavarësisht dhe cilësinë si standarte përcaktuese për lajmet dhe informacionet e aktualitetit, ndërkohë që vendosin pluralizmin si standart përcaktues për gjininë e opinioneve dhe debateve. Diversifikimi i informacioneve në informacione të veçanta, në informacione kulturore, artistike dhe dije, në informacione argëtuese etj, shihet gjithashtu si standart i domosdoshëm për lirinë e informacionit, edhe pse një pjesë e këtyre informacioneve nuk përbejnë interes nga pikëpamja komerciale.

Mosrespektimi i këtyre standarteve dhe mbizotërimi i logjikës së tregut ka sjellë pasoja në aksesin në informacion të publikut sipas M. Vogelsang-ut i cili në një libër të tij ngre shqetësimin se —Impakti në rritje i homogenizimit të industrive televizive i nxitur nga mungesa e kufizimeve kombëtare të pronësisë dhe kufizimeve të integritimit vertikal të programeve është i madh. Historitë e rëndësishme lokale lihen jashtë fasha-orareve më të ndjekura, ose nuk transmetohen fare. Rrjetet e mëdha e kufizojnë aftësinë e kanaleve lokale për të paraqitur historitë lokale...⁵

E theksuam qëllimisht sfidën e pluralizimit dhe diverisitetit të përmbajtjeve dhe të aksesit të publikëve në këto përmbajtje pasi deri tani debati në Shqipëri është përqendruar kryesisht në aksesin e operatorëve në rrjete dhe në shpërndarjen e liçensave të rrjeteve. Çështja e aksesit të operatorëve në rrjete është natyrisht sfidë e

⁵Cooper, M. (2007). Media Ownership and Democracy in Digital Information Age, Creative Commons Washington DC. F. 19

rëndësishme e procesit të dixhitalizimit. Por sfida e pluralizmit, diversitetit dhe aksesit në debatin shkencor për dixhitalizimin shihet si pluralitet tredimensional: —pluralitet i pronësisë, përmbajtjeve dhe zërave”⁶.

Studiuesit e mediave janë marrë me sfidat e politikave rregulluese të tregut të mediave dixhitale. Ata venë re se kontradikta kryesore në këtë drejtim qëndron mes zhvillimeve të shpejta teknologjike dhe ngadalësive së procesit rregullator përmes akteve ligjore. Sipas Ellen, P. Godman-it, —Politikat rregullatore duhet të përgjigjen këtij problemi në tre drejtime:

1. Çfarë shërbimesh të reja do të ofrojnë transmetuesit ekzistues
2. Çfarë shërbimesh do të lejohet të ofrohen në spektrin e ri të transmetimit
3. Si spektri i politikave do të formësojë marëdhënien e re të krijuar mes operatorëve për shkak të infrastrukturës së re teknologjike”⁷

Studiuesi gjerman Kühling duke iu referuar legjislacionit evropian për telekomunikacionet mendon se parimi i neutralitetit teknologjik që buron prej këtij legjislacioni zgjidh një pjesë të mirë të problemeve që kanë të bëjnë me konvergjencën teknologjike por, jo vetëm atë. Ky parim është një përgjigje e mirë për sigurimin e aksesit në rrjete, garantimin e konkurrencës së tregut përmes vendosjes së rregullave, dhe shmangien e monopolizimit të rrjeteve dixhitale. Sipas Kühling-ut —..infrastrukturat teknike duhet të rregullohen në të njëjtën mënyrë. Por e rëndësishme është që parimi i neutralitetit nuk do të thotë vetëm që infrastruktura të jetë e rregulluar në të njëjtën mënyrë: ai do të thotë që edhe përmbajtjet që shpërndahen përmes infrastrukturave të ndryshme duhet të kenë të njëjtin model rregullator”⁸.

⁶ Vogelsang, M. (2010). Digitalisation in Open Economies, Springer Verlag, Heidelberg, f. 120.

⁷ Godman, P. E. (2009), Spectrum Policy and the public interest”, botuar në përmbledhjen e Gerbarg, D. Television Goes Digital, Springer Science, Business Media LLC, New York, f. 183.

⁸ Po aty. F. 12.

David A. L. Levy ka publikuar një studim krahasues për procesin e dixhitalizimit në vendet evropiane të titulluar Europe's Digital Revolution, Broadcasting Regulation. The EU and the Nation State. Aty gjenden aspekte të ndryshme të procesit të dixhitalizimit të trajtuar thellësisht dhe në mënyrë mbresëlënëse nga pikëpamja profesionale. Duke iu referuar një studimi të Martin Cave ai identifikon një sërë anomalish të vërejtura në tregun e mediave dixhitale në Evropë, pikërisht për shkak të moszbatimit të parimit të neutralitetit teknologjik. Këto anomalitë janë: mohimi i shërbimeve të konkurrentëve nga pronarët e rrjeteve, presioni ndaj ofruesve të përmbajtjeve që t'u bashkohen paketave të kanaleve të tyre, kërcënimi i ofruesve të rinj që ta fitojnë aksesin në kushte të papërshtatshme, detyrimi i hyrësve të rinj për të ofruar shërbime të tjera të kushtëzuara nga poseduesit e rrjeteve dhe vendosja e shtërngesave kontraktuale që pengojnë konkurrencën e tregut.⁹

Siç shihet debati për pluralizimin, diversitetin dhe aksesin në epokën dixhitale mbizotërohet nga një —dijë e re dixhitale” që trajton sa prodhimin e përmbajtjeve aq edhe konsumin e tyre. Ajo shtrohet sa në terma të konkurrencës së tregut mediatik aq edhe në terma të lirisë së mediave.

II. Pluralizmi, barazia dhe diversiteti i mediave shqiptarë në epokën dixhitale.

1. Oferta përmbajtësore në procesin e dixhitalizimit.

Është konfirmuar edhe nga përvoja e vendeve të tjera se kalimi nga sistemi analog në atë dixhital krijon mundësi për rritjen e numrit të kanaleve televizive, të diversitetit të përmbajtjeve dhe cilësisë së tyre. Procesi i shpërndarjes së shtatë rrjeteve që ka në dispozicion Republika e Shqipërisë ka përfunduar dhe tashmë ato janë pronësi e 5 kompanive private ndërsa dy prej tyre i përkasin operatorit publik TVSH. Krahas kostove financiare të rrjeteve problemi shtrohet se si

⁹ Levy, A. L. David. (2011) Europe's Digital Revolution, Broadcasting Regulation. The EU and the Nation State. Routledge, London and New York. F. 64.

do t'i përgjigjen me përmbytje kanaanet televizive shqiptare mundësive që krijojnë këto rrjete. Në këtë kuptim problemi shtrohet në dy nivele: së pari, a do të jenë përmbytjet dixhitale vazhdim i përpmbajtjeve të kanaleve televizive analoge, apo infrastruktura e re do të sjellë përmbytje të reja dhe mentalitet të ri. Së dyti mendohet se programacionet do të mbushen me filma, dokumentarë, spektakle. Kush do t'i prodhojë ato? Me çfarë kostojë? A nuk do të konkurrohet kjo media televizive si instrument spektakli nga prodhimet në video në Internet? Thuhet se operatorët televizivë lokalë do të kenë mundësi edhe të kalojnë në rrjetin e transmetimeve të RTSH. Por, a nuk do të lindë rreziku i censurimit të tyre duke shkelur eventalisht neutralitetin e rrjetit prej një ofruesi shërbimesh që ende nuk është pjekur si medie e vërtetë publike? Operatorët lokalë në kushtet e shumëfishimit të kanaleve televizive në ekranin e televizorit, a do të arrijnë ta përballojnë konkurrencën me programe cilësore? Me çfarë kostojë? Mos do të falimentojnë ata, dhe numerizimi i transmetimeve ndofta si teknologji jep mundësinë teorike të diversifikimit të ofertës televizive, por realisht, për shkak të kostove për cilësi në një treg edhe më konkurrencial, në fakt, i përqendron operatorët televizivë në më pak duar? Pse duhet që operatorët privatë të bëjnë investime për rrjete të pavarur prej njeri tjetrit duke bërë shpenzime paralele? A nuk mund t'ja besonin këtë një agjencie të tretë të financuar prej tyre dhe që në mënyrë neutrale administron rrjetin me shumë më pak shpenzime?

Teknologjia për shkak të kostos së lartë i bën zotëruesit e rrjeteve të jenë gjithnjë e më të orientuar drejt një logjike tregu si e vetmja mundësi për ekuilibrimin financiar kosto-fitim. AMA duke respektuar rregullat e tregut dhe interesat financiare të operatorëve do të duhet të mbajë parasysh faktin se infrastruktura dixhitale është një pasuri publike që u është dhënë për përdorim operatorëve privatë. Kjo pasuri publike duhet administruar jo në dëm të interesit të qytetarëve apo në kundërshtim me të drejtat dhe liritë themelore të tyre. Për këtë arsye ajo duhet të ushtrojë rolin e saj dhe duhet të garantojë, programe të diversifikuara, informacione të paanshme, pluralizmin politik dhe diversitetin kulturor, ruajtjen e kufijve mes informacionit dhe publicitetit, garantimin e standarteve të programeve dhe bashkëpunimin me audiencat për kontrollin e këtyre standarteve,

mbrojtjen e disa kategorive moshore nga dhuna dhe pornografia dhe aksesin në informim për grupet e marginalizuara dhe minoritetet etnike.

Kalimi nga sistemet analoge në sistemet numerike përbën një kosto jo vetëm për operatorët zotërues të rrjeteve dhe kompanitë mediatike por, edhe për publikun. Qeveria shqiptare ka deklaruar se do të ndihmojë financiarisht familjet që e kanë të pamundur blerjen e pajisjeve fundore dixhitale për t'u pajisur me to por, kjo nuk është e vetmja pengesë. Shumë shpejt një pjesë e publikut do të vihet para vështirësive të reja që rrezikojnë aksesin e publikut në përmbajtjet dixhitale. Rrjetet dixhitale do të përforcojnë prirjen për pakësimin e programeve të lira dhe rritjen e atyre me pagesë. Po ashtu operatorët privatë mund të jenë shumë arbitrare në vendosjen e tarifave gjë që do të pamundësojë aksesin e publikut. Si përfaqësuese e interesave të publikut AMA do të duhet të ketë një rol të tillë që të garantojë, përballimin e kostove të aparateve marrëse në fazën e kalimit nga analogu në dixhital, garantimin e aksesit të lirë në informacion të operatorëve publikë dhe privatë, vendosjen e një kuote programesh të lira edhe për operatorët privatë, kontrollin mbi tarifat dhe forcimin e operatorit publik si një mundësi e sigurtë minimale aksesi.

2. Rreziku i forcimit të monopoleve në mediat audiovizive

Ekziston rreziku që me kalimin nga transmetimi analog në atë dixhital modeli ekonomik i mediave shqiptare të futet në krizë. Sipas një anketimi të bërë nga Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit të Universitetit të Tiranës, në kuadrin e një projekti të financuar nga AMA (2015) rezulton se pjesa më e madhe e operatorëve lokalë nuk mund t'i përballojë kostot financiare të përshtajës së teknologjive dhe kostot e aksesit në rrjete.

Sipas rregullores së miratuar nga AMA operatorët privatë që nuk janë pronarë rrjetesh do të kenë akses në rrjetin e TVSH-së madje në vendimin e AMA-s nr 54 datë 26.03.2016 përcaktohet edhe shifra prej 1.073 eurosh në muaj që operatorët privatë vendorë do të paguajnë për një alotment. Krahas aksesit në njërin prej rrjeteve të operatorit publik aksesi i tyre bëhet i mundur edhe në 5 rrjetet e tjera private ku sipas rregullores së miratuar po nga AMA, neni 6 thuhet

se: —Subjekti i cili do të licençohet për transmetime numerike kombëtare audiovizive, ka të drejtë të shfrytëzojë deri në 60 për qind të kapacitetit transmetues të rrjetit numerik për mbështetjen e programeve të veta. Subjekti që do të licençohet për transmetime numerike kombëtare audiovizive është i detyruar t'i japë akses në kushte të drejta, të arsyeshme dhe jodiskriminuese, në jo më pak se 40 për qind të kapacitetit të rrjetit numerik të tyre, OSHMA-ve që zotërojnë licencë shërbimi programi audio dhe/ose licencë shërbimi programi audioviziv.. AMA siguron që të gjitha shërbimet që u ofrohen OSHMA-ve, që zotërojnë licencë shërbimi programi audio dhe ose licencë shërbimi programi audioviziv, nga mbajtësit e licencave kombëtare numerike të transmetimit audioviziv, bazohen në kushte të drejta, të arsyeshme dhe jo diskriminuese”¹⁰. Ekziston megjithatë mundësia që nga 70 operatorët televizivë aktualë që operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë vetëm pak prej tyre të mund t'i rezistojnë këtij transformimi.

Dukuria e përqendrimit të shumë mediave në duart e një personi të vetëm është parë me shqetësim dhe është konsideruar si një rrezik për monopolizimin e skenës mediatike shqiptare. Në fakt një rrezik i tillë nuk ekziston vetëm në Shqipëri. Rasti i përqendrimit të mediave në duart e manjatis italian Silvio Berluskoni është rasti më i debatuar në Itali dhe në Evropë, por raste të tjera më pak të dukshme kanë ngjallur debat edhe në vende të tjera. Për këtë arsye me 15 shkurt të vitit 1990 Parlamenti Evropian ka hartuar rezolutën —“Për shkrirjen dhe blerjen e mediave” ku kërkohej vendosja e rregullave që kufizojnë përqendrimin e shumë mediave në një kompani të vetme apo në duart e një personi të vetëm. Në këtë rezolutë deklarohet se —“Kufizimet për përqendrimin, janë të domosdoshme në sektorin e mediave... si një mjet për të garantuar lirinë e informacionit dhe lirinë e shtypit”¹¹.

Edhe më vonë Parlamenti Evropian ka reaguar ndaj përqendrimit të mediave dhe në vitin 1994 ky parlament ka hartuar rezolutën

¹⁰Rregullore për licensimin e rrjeteve numerike dhe programeve të tyre, nëprmet procedurës së Beauty Contest miratuar nga AMA

¹¹Rezoluta për shkrirjen dhe blerjen e mediave. OJ C 68/137-138, 15 shkurt 1990

—Ritralizmi dhe Përqendrimi i Medias në Tregun e Brendshëm” e cila e vinte theksin në rëndësinë që ka pluralizmi i medias në ndërtimin e demokracisë. Në këtë rezolutë dënoheshin përpjekjet për përqendrimin e mediave në grupe të mëdha mediatike sepse sipas kësaj rezolute ky përqendrim dëmtonte si konkurrencën në tregjet e medias ashtu edhe pluralizmin e mediave.

Në Shqipëri edhe pse nuk jemi ende në një situatë të qartë monopolizimi për shkak të liberalizimit të shkajshëm të të gjitha tregjeve përfshi dhe ato të medias, tendenca për përqendrimin e mediave në disa kompani të fuqishme është e dukshme. Natyrisht një prirje e tillë është e natyrshme dhe e imponuar nga dinamika e tregut të mediave, por ajo është me pasoja për pluralizmin e mediave në Shqipëri. Prania e më pak pronarëve në tregun e medias do të sjellë më pak larmi në përmbajtje¹². Pronësia plurale ndikon në pluralizmin e ideve, këndvështrimeve, përmbajtjeve. Përqendrimi i mediave në disa pronarë e bën tregun e mediave më të kontrollueshëm nga interesat ekonomike dhe politike jashtë botës së medias.

Megjithatë është pozitiv fakti se përqendrimi i mediave nuk ka ndodhur si shkak i shkrirjes së mediave me njëra-tjetrën por, si rezultat i krijimit të disa mediave nga i njëjti pronar. Në këtë mënyrë pavarësisht se kemi disa kompani të fuqishme që përfshijnë brenda tyre media të ndryshme nuk kemi pakësim të kanaleve televizive apo të stacioneve radiofonike, përkundrazi numri i tyre është shtuar nga viti në vit.

Një problem mjaft i debatuar në opinionin publik shqiptar ka qenë problemi i kontrollit të tregjeve medike nga biznese të tjera që operojnë jashtë fushës së mediave. Edhe pse legjislacioni shqiptar nuk e ndalon një gjë të tillë, një praktikë e tillë është konsideruar si burim i shumë deformimeve në tregjet shqiptare të medias që nga prishja e konkurrencës së këtij tregu e deri tek konflikti i interesave. Megjithatë debati nuk ka ndikuar në kufizimin e shtrirjes së kontrollit të bizneseve të tjera edhe në tregjet e medias.

¹² Sandra B. Hrvatin dhe Branka Tekovic. Pronësia e medias: ndikimi i saj në pluralizmin dhe pavarësinë e medias. F.10. ISHM. 2004.

Pavarësisht se mediat shqiptare nuk kanë arritur në një situatë përqendrimi bllokuese për konkurrencën dhe në një situatë të rrezikshme për sa i përket lirisë së mediave, prapëseprapë ky përqendrim ka shkaktuar dy probleme kryesore të debatuar shpesh në opinionin publik shqiptar. Problemi i parë ka të bëjë me cënimin e lirisë së ushtrimit të profesionit të gazetarit dhe me deformimin e politikave editoriale për shkak të ndërhyrjes së pronarëve në punën e redaksive dhe në procedurën e botimit të komenteve, opinionëve apo edhe të lajmeve. Problemi i dytë ka të bëjë me rritjen e presionit të politikës mbi mediat për shkak të presionit që ajo ushtron mbi pronarët e mediave.

III. Përfundime.

Me kalimin nga sistemi analog në sistemin dixhital të transmetimeve televizive në Shqipëri mediat por përballen me sfida të rëndësishme mes të cilave më e rëndësishmja është sfida e pluralizmit, e diversitetit të përmbajtjeve dhe e aksesit në rrjete dhe në përmbajtje. Deri tani debati është orientuar drejt aksesit të operatorëve në rrjete dhe konkurrencës për marrjen e licensave në këto rrjete. Shumë shpejt vetë këta operatorë do të ndeshen me probleme dhe sfida të tjera pasi kalimi nga analogu në dixhital nuk është thjeshtë bartje mekanike e përmbajtjeve nga një sistem transmetimi në tjetrin por, edhe ndryshim i vetë përmbajtjeve. Operatorët gjithashtu nuk arrijnë të kuptojnë ndryshimet e audiencës. Kriza e modelit ekonomik të mediave shqiptare mund të sjellë pasoja për pluralizmin e mediave dhe diversitetin e përmbajtjeve që këto media transmetojnë. Institucionet rregullatore, politikëbërëse dhe vendimarrëse duhet të hartojnë strategji, politika dhe ligje të tilla të afta për t'i përballuar sfidat dhe rreziqet me të cilën shumë shpejt do të përballlet sistemi mediatik shqiptar.

IV. Bibliografia.

Cooper, M. (2007). *Media Ownership and Democracy in Digital Information Age*, Creative Commons Washington DC.

De Castel, François. (2004), *La Revolution Communicationnelle, Les enjeux du multimedial*, Editions L'Harmattan, Paris,

Carignani, Andrea. Frigerio, Chiara. Rajola, Federico. (2010), ICT e Società dell'informazione, McGraë-Hill, Milano.

Godman, P. E. (2009), Spectrum Policy and the public intrest", botuar në përmbledhjen e Gerbarg, D. Television Goes Digital, Springer Science, Buisness Media LLC, New York,

Levy, A. L. David, (2011), Europe's Digital Revolution, Broadcasting Regulation. The EU and the Nation State. Routledge, London and New York.

Rooke, Richard,(2009), European Media in the Digital Age, Pearson, London.

Murroni, Christina. Collins, Richards. Coote, Ana. (1996), Converging Communications, Emphasis, London.

Llucy, Kung. Robert, Picard. Toëse, Ruth. (2008), The Internet and the Mass Media, Sage, Los Angeles.

Marsden, C. Arino, M. (2005 Digitisation and Convergence of Interactive Platforms, botuar në Digital Terrestrial Television in Europe, nën kujdesin e Brawn, A. dhe Picard, B. R. LEA, London.

Media Policy for the Digital Age, (2005) WRR/Amsterdam University Press, The Hague/Amsterdam.

Menduini, Enrico. (2007), I media digitali, Laterza, Bari.

Napoli, M. Philip. (2011) Audience Evolution. New Technologies and the Transformation of Media Audiences, Columbia University Press, New York.

Bermejo, Fernand. (2007), The Internet Audience. Constution Measurement, Peter Lang Publishing, New York.

Castells, Manuel. (2009), communication power, Oxford University Press, Osford,

Manovich, Lev. (2001), The Language of Neë Media, Massachusetts Insitute of Technology, Massachusetts.

Media në erën e internetit dhe globalizmit. Përmbledhje studimesh. (2009) ISHM, Tiranë, 2009

Sandra B. Hrvatini dhe Branka Tekovic. Pronësia e medias: ndikimi i saj në pluralizmin dhe pavrësinë e medias. F.10. ISHM. 2004.

Vogelsang, M. (2010). Digitalisation in Open Economies, Springer Verlag, Heidelberg,